

VENDIM
Nr. 211, datë 27.9.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BE-IS ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: “KALIVARË 1”, ME FUQI TË INSTALUAR 578 kw; “KALIVARË 2”, ME FUQI TË INSTALUAR 1234 kw; “KALIVARË 3”, ME FUQI TË INSTALUAR 1653 kw, DHE “KALIVARË 4”, ME FUQI TË INSTALUAR 1998 kw, ME FUQI TOTALE 5463 kw, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË PUKË

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a”; të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “BE-IS Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC-et: “Kalivarë 1”, me fuqi të instaluar 578 kw; “Kalivarë 2”, me fuqi të instaluar 1234 kw; “Kalivarë 3”, me fuqi të instaluar 1653 kw dhe “Kalivarë 4”, me fuqi të instaluar 1998 kw, me fuqi totale 5463 kw, me vendndodhje në Bashkinë Pukë,

konstatoi se:

- Shoqëria “BE-IS Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 580 prot., datë 6.9.2018, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Kalivarë 1”, “Kalivarë 2”, “Kalivarë 3” dhe “Kalivarë 4”, me vendndodhje në Bashkinë Pukë.

- Aplikimi i shoqërisë “BE-IS Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor:
- Neni 9, pika 2, germa “f” (marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM -ja, në rastet e aplikueshme, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës).

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal:

Neni 9, pika 3, germa “b” (bilanci financiar i tri viteve të fundit).

Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).

Për gjithë sa më sipër do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të paraqesë në ERE dokumentacionin e munguar, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BE-IS Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Kalivar 1”, me fuqi të instaluar 578 kw; hidrocentrali “Kalivar 2”, me fuqi të instaluar 1234 kw; hidrocentrali “Kalivar 3”, me fuqi të instaluar 1653 kw, dhe hidrocentrali “Kalivar 4”, me fuqi të instaluar 1998 kw, me fuqi totale të instaluar 5463 kw, me vendndodhje në Bashkinë Pukë, për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti